

Vendim nr. 219 datë 07.10.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Sandër Beci,	Anëtar
Illir Toska,	Anëtar

në datën 07.10.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 15 (D) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **DRITAN ÇOLLAKU**, përfaqësuar nga avokat Xhemal Gazidede, me prokurë.

OBJEKTI: **Konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.**
Shfuqizimi i vendimeve nr. 4278, datë 06.12.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë; nr. 00-2023-5370, datë 26.10.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë, me tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 132, pika 1 dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 41 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjo i relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Dritan Çollaku (kërkuesi) ka qenë i punësuar në Degën e Doganës Qafë-Thanë, prej datës 26.08.2011, në detyrën “përgjegjës turni”, kategoria “C1”, ndërsa me vendimin nr. 2852/4, datë 24.02.2014 të drejtorit të përgjithshëm të Doganave, ai është liruar nga detyra.

2. Me pretendimin se gjatë marrëdhënies së punës ka punuar jashtë orarit zyrtar dhe në ditë pushimi javor e festa zyrtare, në datën 27.03.2015 kërkuesi i është drejtuar gjykatës me padi përmes së cilës ka kërkuar pagimin e pagës së papaguar për ditët e pushimit javor dhe të festave zyrtare të punuara, si dhe të shtesave mbi pagën për punën jashtë orarit për tre vjetët e fundit të punës. Në përfundim të gjykimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 4466, datë 16.09.2015, ka pranuar pjesërisht padinë, duke detyruar palën e paditur, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (*DPD*), t’i paguajë kërkuesit pagën e papaguar për ditët e pushimit javor dhe të festave zyrtare të punuara, si dhe shtesat mbi pagën në masën 50% për punën jashtë orarit, për një pjesë të periudhës së pretenduar nga ai (27.03.2012 - 23.01.2014), në shumën totale 1.411.541 lekë. Pjesa tjetër e kërimit në padi (për periudhën 23.01.2011 - 23.01.2012) nuk është pranuar, për shkak të parashtrimit referuar nenit 203, pika 1, të Kodit të Punës (*KP*). Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim pala e paditur, *DPD*-ja.

3. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 4278, datë 06.12.2016, ka vendosur ndryshimin e vendimit të shkallës së parë dhe rrëzimin tërësisht të padisë së kërkuesit. Për rekursin e kërkuesit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-5370, datë 26.10.2023, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e tij.

4. Në datën 08.07.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000 është regjistruar më 24.07.2024. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr.8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore të anëtarëve të Gjykatës, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuetit

5. **Kërkueti** ka pretenduar se vendimet e kundërshtuara i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

- 5.1. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në raste analoge me atë të kërkuetit ka mbajtur qëndrime të ndryshëm nga ai i mbajtur në çështjen e tij.
- 5.2. *Së drejtës për një gjykim të drejtë e të paanshëm*, pasi vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë është në zbatim të gabuar të ligjit material dhe procedural, duke mos u thelluar në përcaktimin e shkeljeve ligjore të kryera nga gjykata e apelit. Ai kolegji ka lejuar shkeljen ndaj kërkuetit të së drejtës së pagës shtesë për orët e punuara në turnin e dytë dhe të tretë, si dhe për orët e punuara në ditët e pushimit javor dhe festave zyrtare, duke mos marrë në konsideratë edhe vetë praktikën e tij gjyqësore.
- 5.3. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuetit pa arsytim dhe pa argumente ligjore, duke mos u shprehur për shkeljen e ligjit material nga gjykata e apelit për sa i përket moszbatimit të neneve 81 dhe 91, pikat 1 dhe 3, të KP-së, si dhe të VKM-së nr. 511, datë 24.10.2002, të ndryshuar.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuetit

6. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë njëkohësisht kriteret kumulative të parashikuara në nenin 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të

drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

7. Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor të kundërshtuar, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e paraqitur, për rrjedhojë është bartës i të drejtave kushtetuese të pretenduara të cenuara.

8. Në lidhje me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individit mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individit t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 31, datë 03.11.2022; nr. 15, datë 07.05.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

10. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se vendimi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi është dhënë nga Gjykata e Lartë në datën 26.10.2023, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 08.07.2024 (*data e dorëzimit në shërbimin postar*). Nga komunikimi elektronik i datës 06.09.2024, Gjykata e Lartë ka konfirmuar se vendimi i kundërshtuar nga kërkuesi është publikuar në faqen e saj zyrtare, duke u bërë i disponueshëm për palët në datën 04.01.2024. Nga ana tjetër, referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij shqyrtimi, Kolegji

konstaton se në aktin e rekursit, avokati i caktuar nga kërkuesi me prokurë të posaçme ka lënë të dhënat elektronike të kontaktit të tij, të dhënat e postës elektronike (*e-mail*), por pavarësisht kësaj, nuk rezulton që sekretaria gjyqësore e Gjykatës së Lartë t'ia ketë njoftuar vendimin e arsyetuar të saj në rrugë elektronike.

12. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se në kushtet kur përfaqësuesi i kërkuesit kishte lënë të dhënat elektronike të kontaktit dhe nga ana e Gjykatës së Lartë nuk i është njoftuar vendimi i arsyetuar në rrugë elektronike, paraqitja e ankimit kushtetues individual në datën 08.07.2024 konsiderohet brenda afatit ligjor 4-mujor dhe, për pasojë, kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*.

13. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të sigurisë juridike në drejtim të pritshmërive të ligjshme, së drejtës për një gjykim të drejtë e të paanshëm, si dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, pretendime të cilat për nga mënyra se si janë trajtuar, në thelb, kanë të bëjnë me mënyrën se si gjykatat e zakonshme, duke rrëzuar padinë e tij, kanë zbatuar dispozitat ligjore dhe praktikën gjyqësore të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë, këto pretendime do të analizohen në këndvështrim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me sigurinë juridike.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me sigurinë juridike

14. Kërkuesi ka pretenduar se në raste analoge me çështjen e tij, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka mbajtur qëndrim të ndryshëm nga ai i mbajtur në rastin konkret. Sipas tij, vendimi i këtij kolegji është në zbatim të gabuar të ligjit material dhe procedural, duke mos u thelluar në përcaktimin e shkeljeve ligjore të kryera nga gjykata e apelit, çka i ka shkelur të drejtën e pagës shtesë për orët jashtë orarit dhe e punuara në turnin e dytë dhe të tretë, si dhe për orët e punuara në ditët e pushimit javor dhe festave zyrtare, duke mos marrë në konsideratë edhe vetë praktikën e tij gjyqësore. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, vijon kërkuesi, ka vendosur mospranimin e rekursit të tij pa arsyetim dhe pa argumente ligjore, duke mos u shprehur mbi shkeljen e ligjit material nga gjykata e apelit për sa i përket moszbatimit të neneve 81 dhe 91, pika 1 dhe 3, të KP-së, si dhe të VKM-së nr. 511, datë 24.10.2002, të ndryshuar.

15. Gjykata ka vlerësuar se parimi i sigurisë juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin (*shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 4, datë 21.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Kur kërkuesit kanë pretenduar cenimin e parimit të sigurisë juridike në lidhje me mënyrën se si gjykatat kanë vendosur në raste të ngjashme, Gjykata ka theksuar se vlerësimi kushtetues i mënyrës së

zgjdhjes së çështjeve të ngjashme nga gjykatat e zakonshme bëhet rast pas rasti, ndërkohë fakti që gjykatat e zakonshme kanë vendosur ndryshe në një rast të ngjashëm, në vetvete nuk mund të justifikojë apriori pretendimet e individit, pasi mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, për sa kohë çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, harmonizuar edhe me rrethana, faktorë, motive ose prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë të njëjta (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 17, datë 23.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata ka pohuar se pproblemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues nëse nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim para tyre nuk përbën lëndë kushtetuese, me përjashtim të rastit kur kjo mënyrë veprimi e gjykatës së zakonshme provohet se ka cenuar të drejta kushtetuese të individit që vë në lëvizje këtë Gjykatë, në kuptimin që procesi në tërësinë e tij rezulton haptazi i paarsyeshëm ose arbitrар (*shih vendimin nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata është shprehur se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyeimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 79, datë 14.12.2017; nr. 63, datë 23.09.2015; nr. 3, datë 26.01.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjithsesi, zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata, rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes dhe natyrës së vendimit, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 79, datë 14.12.2017 të Gjykatës*

Kushtetuese). Gjykata ka pohuar se vendimet e Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015; nr. 37, datë 19.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Duke iu rikthyer rastit konkret, Kolegji vëren se ndërsa padia e kërkuetit është pranuar pjesërisht nga gjykata e shkallës së parë, mbi ankimin e palës së tij kundërshtare në procesin gjyqësor mes tyre, gjykata e apelit ka arritur në përfundime të ndryshme për çështje të faktit dhe zbatimin e ligjit. Sipas gjykatës së apelit, marrëdhënia juridike në konflikt mes palëve rregullohet jo vetëm nga nenet 87 dhe 91 të KP-së, por edhe nga aktet nënligjore të dala në zbatim të këtij kodi dhe legjisllacioni në përgjithësi, sikundër është VKM-ja nr. 511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, e ndryshuar (*VKM nr. 511/2002*) dhe udhëzimi nr. 16, datë 20.07.2011 i ministrit të Financave. Referuar VKM-së nr. 511/2002, përjashtimisht, punonjësi që kryen veprimtari operacionale, në rastet kur është e pamundur dhënia e pushimit për orët shtesë në punë, ka të drejtë të kompensohet me shtesë mbi pagën normale. Gjykata e apelit ka arsyetuar se nuk provohet që paditësi (kërkueti) të ketë kryer veprimtari që, përjashtimisht, në pamundësi të kompensimit të orëve shtesë me pushim, të procedohet me kompensimin e tyre me pagesë. Sipas saj, provohet se pas çdo dite shërbimi 24-orësh, ai nuk ka qenë i planifikuar në shërbim për 48 orët në vijim, që do të thotë se kompensimi i punës së kryer në orët shtesë të jetë bërë me pushim sipas përcaktimeve të neneve 87 e 91 të KP-së dhe VKM-së nr. 511/2002, ndërkohë që nuk provohet dhe as pretendohet që ky kompensim të mos jetë kryer i plotë nga punëdhënësi i paditur. Sipas gjykatës së apelit, paditësi nuk mund të pretendojë pagimin e orëve shtesë të punës në kuptim të nenit 14, pika 3, të VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, por gëzon të drejtën e kompensimit me pushim, kompensim i cili është ofruar nga punëdhënësi i paditur, ndërsa ai nuk provon të ketë kryer orë pune shtesë dhe orë pune gjatë ditëve të pushimit zyrtar, mbi bazën e urdhrin të titullarit dhe të mos jetë kompensuar me pushime në masën e përcaktuar nga ligji.

20. Për rekursin e kërkuetit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se ai nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, sipas përmbajtjes së tij në kohën e paraqitjes së rekursit. Në vendimin e atij kolegji, ndërsa pasqyrohen shkaqet e ngritura në rekursin e kërkuetit, jepet edhe vlerësimi i kolegjit se në rekurs nuk ngrihen problematika që bëjnë të mendohet se gjykata më e ulët ka zbatuar

gabim ligjin material apo procedural, ndërsa nuk pretendohet që vendimi i asaj gjykate bie ndesh me vendime të Kolegjit Administrativ apo vendimet e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe as për shkelje të rëndë nga ajo të normave procedurale, ndërkohë që pretendimet për çështje të faktit nuk përfshihen në kompetencën funksionale të Gjykatës së Lartë.

21. Nga sa më lart, referuar përmbajtjes së vendimeve gjyqësore objekt kërkesë, Kolegji vlerëson se ato i përmbushin elementet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Vendimet përmbajnë të dhënat e palëve, shkaqet e parashtruara në ankimin/rekurs, vendimet e gjykatave më të ulëta, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku kanë mbështetur qëndrimin e shprehur në dispozitiv. Gjykata e apelit ka rrëzuar padinë e kërkuarit, duke arsyetuar vendimin e saj në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm, ndërsa Gjykata e Lartë, pavarësisht se me arsyetim të kufizuar, ka evidentuar shkaqet e ngritura në rekursin e kërkuarit, sikundër edhe vlerësimin e saj për sa u përket kritereve të pranueshmërisë së tij për shqyrtim. Vendimet nuk rezultojnë të jenë alogjike, kontradiktore ose të paqarta në përmbajtjen dhe vlerësimin e tyre. Për sa kohë nga kërkuari nuk argumentohet se zbatimi i ligjit nga gjykatat e zakonshme ka qenë eventualisht arbitrarisht, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës, vetëm fakti se në përfundim të procesit gjyqësor, në të cilin palët kanë pasur mundësinë të ushtrojnë garancitë e tyre procedurale, gjykatat kanë dhënë një vendim jo në favor të tij, nuk është i mjaftueshëm për të provuar cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor.

22. Po ashtu, Kolegji evidenton se vendimi gjyqësor bazohet, në çdo rast, në vlerësimin e rrethanave të çështjes konkrete në shqyrtim dhe të provave të administruara në atë gjykim. Për rrjedhojë, fakti që në rastin e kërkuarit gjykatat kanë arritur në një përfundim të ndryshëm nga çështje të tjera në dukje të ngjashme, nuk përbën *apriori* cenim të parimit të sigurisë juridike. Çështja e pritshmërive të ligjshme dhe pretendimet në tërësi të kërkuarit, për nga mënyra se si janë ngritur, kanë të bëjnë me mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, që, si rregull, është atribut i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe për pasojë nuk përbëjnë lëndë kushtetuese.

23. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e sigurisë juridike është haptazi i pabazuar.

24. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.